





**Doracak me  
10 skenarë të  
reagimit për rastet  
e sinjalizimit në  
sektorin privat**

Web: [www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)  
Addressa: Andrea Gropa, No.35  
10000 Prishtinë, Kosovë

Të drejtat e autorit @ 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij Doracaku nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



Norwegian Embassy



Publikimi i këtij Doracaku është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



# Përmbajtja

<b>SKENARI #1</b>	Sinjalizimi për mos pagesën e tatimeve	4
<b>SKENARI #2</b>	Sinjalizimi për keq- administrimin e drejtësisë	6
<b>SKENARI #3</b>	Sinjalizimi për dëmtimin e ambientit	8
<b>SKENARI #4</b>	Sinjalizimi për sigurinë e njerëzve në kontekst të ndërtimit	9
<b>SKENARI #5</b>	Sinjalizimi në kontekst të mbrojtjes së shëndetit në fushën e shëndetësisë	11
<b>SKENARI #6</b>	Sinjalizimi për mospagesë të kontributeve pensionale për punonjësit e marketeve	13
<b>SKENARI #7</b>	Sinjalizimi për shërbim të produkteve ushqimore të rrezikshme	14
<b>SKENARI #8</b>	Sinjalizimi në kontekst të institucioneve financiare	16
<b>SKENARI #9</b>	Sinjalizimi për cenim të të dhënave personale	18
<b>SKENARI #10</b>	Sinjalizimi për shkelje të të drejtave të autorit	20

Ky dokument është një nga produktet e projektit “Sinjalizues, ligji ju mbron”, i cili synon të kontribuojë drejtpërsëdrejti në ndërtimin e urave dhe kanaleve të komunikimit ndërmjet institucioneve të ndryshme dhe sektorit privat. Dokumenti synon që të paraqesë dhjetë (10) skenarë të reagimit në rastet e sinjalizimit në sektorin privat.



## **SKENARI #1:**

**Sinjalizimi për  
mos pagesën e  
tatimeve**



Përkundrazi, drejtori i korporatës vazhdimisht deklaronte në takime që “duhet me u kujdese në raport me shtetin, mos me pas asnjë shmangie në raport me taksat dhe tatimet”. Bledi dhe Zana e kuptuan më vonë se kjo shmangie ishte bërë në koordinim në mes të Financierit kryesor dhe Menaxherit të përgjithshëm.





## SKENARI #1:

### Sinjalizimi për mos pagesën e tatimeve

#### Faktet e supozuara:



Bledi dhe Zana kanë punuar për dy (2) vite në sektorin publik si Auditorë junior në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA). Para tre (3) muajsh Zana kishte parë një shpallje për dy pozita në auditimin e brendshëm në Kompaninë “Korporata e Pasur” me seli në Prishtinë, por që funksionon dhe ofron shërbime e produkte në tërë Kosovën dhe në rajon. Pasi i kishin shqyrtuar kriteret e konkursit pozitat e shpallura dukeshin mjaft atraktive për sa i përket përgjegjësive të punëve dhe kompensimit financiar. Ata aplikuan dhe u punësuan në Departamentin Qendror të Auditimit në këtë kompani. Por gjatë punës së tyre në vijim, kishin vërejtur që korporata kishte bërë mos-paraqitje e tatimeve në organet shtetërore. Kompania këtë e kishte bërë duke i deformuar të dhënat pasqyrat financiare për të shmangur tatimet publike. Për këtë ata kishin prova të pa mohueshme edhe pse për fillimin e sinjalizimit mjaftonte vetëm dyshimi për këto shkelje. Por, ata kuptuan, ndërkohë që kjo ishte bërë pa dijeninë e drejtuesëve të Kompanisë së “Korporatës së Pasur”. Përkundrazi, drejtori i korporatës vazhdimisht deklaronte në takime që “duhet me u kujdesë në raport me shtetin, mos me pas asnjë shmangie në raport me taksat dhe tatimet”. Bledi dhe Zana e kuptuan më vonë se kjo shmangie ishte bërë në koordinim në mes të Financierit kryesor dhe Menaxherit të përgjithshëm. Duke qenë auditor ata kishin qasje të gjerë në dokumentet dhe komunikimet e korporatës. Gjatë një auditimi ata vërejtën që këta zyrtarë të kompanisë kishin shkëmbyer e-maile që dëshmonin shmangiet tatimore dhe deformimin e të dhënave financiare me qëllim “të ngritjes së profitabilitetit të kompanisë dhe uljes së shpenzimeve të panevojshme e që mund të shmangen pa probleme të mëdha”.

Zana dhe Bledi janë auditorë me integritet të lartë profesional dhe etikë të punës të cilën nuk duan ta komprometojnë në asnjë rast.<sup>1</sup> Ata ishin të informuar për sinjalizimin në përgjithësi. Kur ata punonin në Zyrën Kombëtare të Auditimit ata kishin mbajtur një trajnim mbi sinjalizimin në sektorin publik. Por ata tani duan të dinë se a janë të mbrojtur nga ligji, nëse vendosin të paraqiten si sinjalizues, në sektorin privat? Po ashtu, ata pyesin nëse sinjalizimin duhet ta adresojnë tek ndonjë palë e autorizuar apo ta shfaqin publikisht?

## Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren

Pyetja e parë që duhet të adresohet është nëse ata gëzojnë mbrojtje ligjore që të paraqiten si sinjalizues në sektorin privat? Vërehet që qysh në dispozitat e para Ligji ka përcaktuar që “Qëllimi i këtij ligji është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve”. Andaj është e qartë që sinjalizimi në sektorin privat është i mbrojtur dhe i garantuar sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve. Por trajtimi i kësaj pyetje nuk mjafton për të përcaktuar veprimet që duhet apo që mund të ndërmerren.

Në vijim duhet të trajtojmë pyetjen tjetër që Bledi dhe Zana kanë ngritur. Pyetja ishte nëse sinjalizimin duhet ta adresojnë tek ndonjë palë e autorizuar apo ta shfaqin publikisht? Ligji ka përcaktuar tri mundësi të sinjalizimit: (i) brendshëm; (ii) jashtëm dhe (iii) publik (shpalosja).

Zana dhe Bledi mund të zgjedhin njërin nga këto mënyra për sinjalizim. Sinjalizimi i brendshëm bëhet tek punëdhënësi. Në këtë rast Bledi dhe Zana, nëse zgjedhin këtë lloj të sinjalizimit, do të mund ti drejtoheshin kompanisë “Korporata e Pasur”. Sipas Ligjit, sinjalizimi i brendshëm duhet të bëhet tek zyrtari përgjegjës (që sipas Ligjit nënkupton “personi i caktuar nga institucioni publik apo subjekti privat për të pranuar dhe trajtuar sinjalizimin”). Mirëpo, duhet theksuar që Ligji ka përcaktuar një kriter për subjektet private lidhur me obligimin e pasjes së një zyrtari të tillë. Me nenin 17 par.1 të Ligjit është përcaktuar që vetëm subjektet private me mbi pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës. Andaj, Bledi dhe Zana duhet të konsiderojnë këtë element për të ditur nëse e kanë mundësinë e adresimit të zyrtarit përgjegjës brenda institucionit.

---

<sup>1</sup> Integriteti mes tjerash përfshinë: respektimin e standardeve të etikës; mbizotërimi i interesat publik; raportimin e praktikave apo veprimeve që shpjen në keqpërdorime; promovimin e drejtave të njeriut duke shmangur ngacmimin dhe diskriminimin; promovimin dhe rekrutimin transparent dhe meritore të personalit.

Një mënyrë tjetër, të cilën Zana dhe Bledi mund ta përdorin është sinjalizimi i drejtpërdrejtë tek drejtuesi i subjektit privat sipas paragrafit 4 të nenit 17 të Ligjit. Në këtë rast kjo duket më adekuatë duke qenë se korporata mund të mos ketë zyrtarë përgjegjës për sinjalizim apo edhe nëse ka ai mund të jetë i kontrolluar apo i përfshirë ngushtë me palët që janë të përfshira në mashtrim. Në rastin konkret, duke pasur parasysh që Bledi dhe Zana kishin kuptuar që Drejtori i korporatës ishte kundër parregullsive në raport me taksat dhe tatimet, ata mund t'i drejtohen drejtpërdrejtë Drejtorit të Korporatës në pajtim me nenin 17.

Zana dhe Bledi mund po ashtu të konsiderojnë sinjalizimin e jashtëm. Kjo mund të bëhet para, paralelisht apo pas sinjalizimit të brendshëm. Sinjalizimi i jashtëm sipas ligjit është "Raportimi i informacionit tek autoriteti kompetent". Ligji ka përcaktuar që "Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim të jashtëm pasi ka kryer sinjalizimin e brendshëm apo drejtpërdrejtë sinjalizim të jashtëm". Kjo dispozitë është me rëndësi sepse nuk ju imponon sinjalizueseve që patjetër të përdorin sinjalizimin e brendshëm para se të bëjnë sinjalizimin e jashtëm. Kjo sepse nëse do të ishte një kriter i atillë do të mund t'i jepte rast subjekteve private (kompanive) që të evitonin, apo dëmtonin provat dhe dëshmitë që janë objekt i sinjalizimit të jashtëm.

Në lidhje me sinjalizimin e jashtëm në sektorin privat, Ligji ka përcaktuar që sinjalizimi tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë zbatohet përshtatshmërisht me procedurat që parashihen për sinjalizimin e brendshëm. Për sa i përket cilëve rregullatorë ata mund të ju drejtohen nëse zgjedhin këtë sinjalizim duke pasur parasysh fushën e shkeljeve Bledi dhe Zana, rregullatorë të kësaj fushe janë: Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), përkatësisht Zyrës për Gjaba dhe Dënime Administrative (ZGJONA) apo ndonjë departamenti tjetër sipas instruksioneve të ATK-së. Paralelisht, ata mund ti drejtohen edhe Prokurorit të Shtetit apo Policisë së Kosovës, Departamentit Përkatës për Krime ekonomike. Po ashtu duhet thënë që neni 19 i Ligjit duhet lexuar edhe në ndërlidhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës që përcakton obligimin e gjithsecilit raportimin e veprave penale në Polici dhe Prokurori.





## **SKENARI #2:**

**Sinjalizimi  
për keq -  
administrimin e  
drejtësisë**



"Këqyre, Genc, unë e di që ai Juristi na ka njoftu që nuk kemi shancë me fitu rastin në Gjykatë. Por ne nuk kemi mundësi të mbijetojmë nëse nuk e fitojmë tenderin 47 Milionësh. S'kam çka me ba tjetër. Njani më tha që me 120 mijë euro kryhet në Gjykatë. E kthejmë rastin në pikën zero tani kqyrim çka po mundemi me ba në OSHP. A po kupton? Duhesh me gjetë një mënyrë me evidentu këtë 120 mijë euro në librat e kontabilitetit."



## SKENARI #2:

# Sinjalizimi për keq - administrimin e drejtësisë

## Faktet e supozuara:



Genci punon si kontabilist në kompaninë “Tenderi Sh.P.K.”. Kjo kompani merret me implementim të projekteve dhe shërbimeve të financuara nga Ministria e Transportit. Para dy jave, kompania kishte humbur një rast në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik (tutje: OSHP) për një projekt ndërtimi të një rruge magjistrale në vlerë 47 milion Euro. Kompania kishte vetëm edhe një mjet për të ndërruar këtë situatë: të ushtronte padi në gjykatën kompetente. Megjithatë, Zyra Ligjore e kompanisë që drejtohet nga juristi Drin Drini kishte lëshuar një opinion për kompaninë ku listonte anët e mira dhe anët e dobëta të rastit. Ai kishte ardhur në përfundimin që kompania nuk kishte një rast të mirë për gjykatë andaj kishte rekomanduar që të mos shpenzohej kohë, energji dhe burime për të hapur rastin gjyqësor.

Por, Drejtori i Përgjithshëm të kompanisë z. Maksut Maksuti, ftoi Gencin në takim në zyrën e tij dhe i kërkoi 120,000 Euro kesh nga llogaritë e Kompanisë. Genci e pyeti pse duheshin këto mjete, Drejtori i Përgjithshëm e njoftoj Gencin që ato mjete i duheshin për t’ia dhënë nga një “dhuratë të vogël” për disa persona në gjykatë (gjyqtarë, staf administrativ, avokat). Genci u shokua por nuk shfaqti panik dhe Drejtori e vërejt i ketë dhe i drejtua me fjalët: “Këqyre, Genc, unë e di që ai Juristi na ka njoftu që nuk kemi shancë me fitu rastin në Gjykatë. Por ne nuk kemi mundësi të mbijetojmë nëse nuk e fitojmë tenderin 47 Milionësh. S’kam çka me ba tjetër. Njani më tha që me 120 mijë euro kryhet në Gjykatë. E kthejmë rastin në pikën zero tani kqyrim çka po mundemi me ba në OSHP. A po kupton? Duhesh me gjetë një mënyrë me evidentu këtë 120 mijë euro në librat e kontabilitetit.” Genci e njoftoj Drejtorin e Përgjithshëm që do të shoh se çka mund të bëjë. Me aq takimi përfundoj. Më vonë gjatë javës Genci shkoj t’i nxjerrë 120 Mijë Euro nga “Banka”. Banka i kërkoi një autorizim shtesë nga Drejtori ose që Drejtori të vinte vet, pasi që shuma ishte e lartë.



Në të njëjtën ditë Genci i shkruajti një emali Drejtorit me këtë përmbajtje (pjesët më relevante): “ - Banka nuk më lejojti të tërheqë mjetet për dhuratën që biseduam meqë shumica ishte a lartë. Më duhet një autorizim”. Maksuti i dërgoi autorizimin e kërkuar pas disa orësh. Të nesërmen, Genci tërhoqi paratë nga Banka dhe ja solli në zyrë Maksutit. Ai e njoftoi Gencin që kishte biseduar me një avokat dhe kishin caktuar takimin pas dy javësh dhe se kishte marrë garanci që “puna kryhet me 120 mijë”.

Pasi u kthye në zyrën e tij, Genci filloi të mendonte për hapat tjerë. Ai nuk donte të përzihej në këtë punë, por ishte i detyruar të kryente tërheqjen e parave sepse ishte i autorizuar dhe kishte në përshkrim të detyrave që të udhëheqë çështjet e financave dhe kontabilitetit. Por, integriteti i tij profesional dhe etika e punës i thoshte që ta raportonte këtë rast sepse e dinte që drejtësia ishte në rrezik të dëmtohej në mënyrë joligjore. Genci vendosi në fund të ditës që këtë rast do ta sinjalizonte. Ai nuk ishte i sigurt se a e mbronte ligji për këso sinjalizime? Rasti bëhej më i komplikuar sepse ky sinjalizim do të përfshinte sektorin privat por edhe atë publik. Dhe mbi të gjitha Genci kishte hezitime se kujt t’i drejtohej, dhe si ishte procedura e një sinjalizimi të tillë?

## **Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren**

Por Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizueseve (nenit 5) përcakton se sinjalizimi është në interesin publik dhe i mbrojtur, edhe në rastet kur “ka ndodhur, është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë keqadministrimi i drejtësisë”. Andaj, në rastin konkret Genci është i mbrojtur nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizueseve dhe neni 5 paraqet bazë për sinjalizim në rastet e keqadministrimit të drejtësisë. Meqë këtu është në pyetje Drejtuesi i Kompanisë, sipas (nenit 18) Genci është i lejuar që të bëjë drejtpërdrejtë sinjalizimin e jashtëm. Ky nen përmban disa kritere se kur mund të bëhet sinjalizimi i jashtëm. Ndër to më të rëndësishmet, dhe që aplikohen në rastin konkret janë kriteret në vijim:

Tani na duhet të sqarojmë pyetjen e fundit të Gencit: se kujt ti drejtohej, nëse sinjalizimi lejohej, dhe si ishte procedura e një sinjalizimi të tillë? Duke qenë se ky sinjalizim është më kompleks për faktin se në të përfshihen edhe palë publike por edhe palë private përgjigjen do ta ndajmë në dy pjesë.

Së pari, në raport me sinjalizimin për sjelljet potenciale korruptive të gjuqtarëve, stafit administrative, dhe avokatëve Genci duhet t'i drejtohet Agjencisë Kundër Korrupsion (AKK). Kjo sepse sipas nenit 18 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve AKK është kompetente për të trajtuar sinjalizimin e jashtëm në sektorin publik. Andaj edhe pse Genci nuk është punonjës publik, fakti që sinjalizimi në fjalë do të bëhej kundrejt punonjësve të sektorit publik është element i mjaftueshëm për të përcaktuar kompetencën e AKK-së në këtë rast. Për më tepër, AKK merr këtë kompetencë edhe nga legjislacioni bazë për themelimin dhe fushë veprimtarinë e saj. Gjithashtu Genci mund ti drejtohet Kryetarit të Gjykatës, dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Për sjelljet potenciale korruptive të avokatit të përmendur si ndërmjetësues, Genci duhet t'i drejtohet Zyrës së Prokurorit Disiplinorë që funksionon në kuadër të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Së dyti, në raport me sinjalizimin e sjelljes potenciale korruptive të Drejtorit të Kompanisë Genci mund t'i drejtohet disa institucioneve. Para së gjithash, sipas legjislacionit në fuqi për raportimin e veprave penale ai duhet ti drejtohet policisë dhe prokurorisë. Kompetenca e tillë e këtyre organeve caktohet me Ligjin për Policinë dhe Kodin Penal si dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Kjo sepse sinjalizimi në rastin konkret bëhet mbi bazën e keqadministrimit të drejtësisë dhe këto organe janë kompetente për të hetuar dhe ndjekur llojet e tilla të veprave.



**SKENARI #3:**

**Sinjalizimi për  
dëmtimin e  
ambientit**





Dy ditë pas këtij raporti Besniku u ftua në takim me Drejtorin e kompanisë z. Shkatërruesi i Natyrës. Ai kërkoi nga Besniku që “të mos e bëjë të madhe këtë punën e dezinfektueseve sepse me shumë gjasë do të hiqen nga shiu i parë ose i dytë”.



### SKENARI #3:

## Sinjalizimi për dëmtimin e ambientit

### Faktet e supozuara:



Besniku punon si laborant/kimist në kompaninë "Higjiena Natyrore". Kompania merret me shërbime të dezinfektimit sipas kërkesave të tenderëve me Komunitet e Kosovës. Kohët e fundit Besniku mësoj që kompania me qëllim që të kursente në koston e dezinfektuesëve kishte blerë disa më të lirë. Ato do të reduktonin koston e shpenzimeve për 40%. Problemi u shfaq kur disa mostra të dezinfektuesëve të ri një ju dërguan Besnikut për testim në laboratorin e kompanisë.

Besniku kuptoj që dezinfektuesit ishin shumë të fuqishëm për qëllimin që kishin dhe se nuk do të hiqeshin lehtë nga natyra edhe pas reshjeve (siç, normalisht ndodh). Ai shkruajti raportin e tij laboratorik me rekomandimin kryesorë që "Kemikalet/ dezinfektuesit e tillë **nuk duhet të përdoren për shkak të efekteve negative afatgjata në insekte, kafshë dhe bimë**. Këto efekte mund të jenë afatgjate dhe rrjedhimisht të barten edhe tek njerëzit përmes ciklit të ushqimit."

Dy ditë pas këtij raporti Besniku u ftua në takim me Drejtorin e kompanisë z. Shkatërruesi i Natyrës. Ai kërkoi nga Besniku që "të mos e bëjë të madhe këtë punën e dezinfektuesëve sepse me shumë gjasë do të hiqen nga shiu i parë ose i dytë". Po ashtu ai kërkoi nga Besniku që të mos e ndajë raportin e tij laboratorik me kolegët tjerë të kompanisë "Higjiena Natyrore". Hedhja e planifikuar e këtyre kemikaleve do të bëhet fillimisht në "Komunitet e Pastër" javën tjetër. Besniku është një profesionist me etikë të lartë dhe integritet profesional. Ai dëshiron ta raportoj këtë shkelje por dëshiron të dijë çka të bëjë më tutje? Ai nuk dëshiron të jetë pjesë e kësaj katastrofe natyrore. Si duhet të sinjalizojë Besniku këtë rast? Kujt duhet ti drejtohet (sinjalizimin e brendshëm, të jashtëm apo publik)?

## Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren

Në rastin konkret Besniku ngritë një shqetësim shumë serioz dhe urgjent. Hapësirat e një komune të tërë janë afër dezinfektimit me një substance që mund të dëmtoj insektet, bimët dhe të ketë efekte negative edhe në kafshë dhe rrjedhimisht edhe në ushqimin që njerëzit e asaj komune konsumojnë përgjatë vitit.

Sikurse në rastet e tjera Besniku i ka disa alternative. Edhe pse në teori Besniku mund të bëjë sinjalizimin e brendshëm, ai me shumë gjasë nuk do të jetë efektiv duke qenë se vetë Drejtori i kompanisë i kishte thënë Besnikut që ta heshtë rastin. Andaj në raste të tilla sinjalizimi i jashtëm dhe sinjalizimi publik (shpalosja) duket që mbesin alternativat prej të cilave mund të pritet ndonjë rezultat.

Lidhur me sinjalizimin dhe bazat për sinjalizim ne duhet të i referohemi nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve. Aty përcaktohet se një nga bazat pse sinjalizimi në interesin publik është i mbrojtur, përfshihen edhe situatat kur “shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet” apo kur “personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor”. Si bazë shtesë aty përcaktohet që sinjalizimi është në interes publik kur **“mjedisi është dëmtuar, është duke u dëmtuar ose ka gjasa të dëmtohet”**. Andaj, në rastin konkret Genci është i mbrojtur nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizueseve dhe neni 5 paraqet bazë për sinjalizim në rastet e keqadministrimit të drejtësisë.

Pyetja vijuese që Besniku ngritë me të drejtë është se kujt duhet t’i drejtohet? Vërejmë që neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve përcakton që në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat sinjalizimi bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Andaj duke qenë se situata aktuale ka të bëjë me mjedisin dhe rrezikun eminent të dëmtimit të mjedisit, Besniku duhet të bëjë sinjalizimin e jashtëm tek Departamenti për Inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor - Divizioni për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave. Ky organ funksionon në kuadër të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë. Besniku, meqë i ka provat, mund t’i ofrojë ato edhe pse në këto raste vetëm dyshimi, për shkeljet që pritet të ndodhin në një të ardhme të afërt përmes dezinfektimit me materiale të dëmshme në Komunën e Pastër, është bazë e mjaftueshme për sinjalizim.

## **SKENARI #4:**

**Sinjalizimi  
për sigurinë  
e njerëzve në  
kontekst të  
ndërtimit**



Arbeni i ka të gjitha provat që dëshmojnë këto shkelje. Si inxhinier me integritet profesional dhe etike qytetare ka vullnetin dhe ndjenë obligimin që të raportoj këtë ngjarje. Ai vetëm nuk e dinë se si të vazhdoj në sinjalizimin e këtij rasti? A duhet t'i drejtohet drejtorit të kompanisë "Ndërtimi i Dobët" apo ndonjë pale apo institucioni tjetër? Ai dëshiron të dijë si të veproj në këtë rast?







## SKENARI #4:

# Sinjalizimi për sigurinë e njerëzve në kontekst të ndërtimit

## Faktet e supozuara:



Arbeni punon si inxhinier kryesorë në kompaninë “Ndërtimtari i Dobët”. Kompania merret me ndërtimet të larta të objekteve të banimit. Ai ka vërejtur që kompania është duke përdorur materiale dhe teknika të ndërtimit që nuk janë në pajtim me standardet e ndërtimit të përcaktuara në “Kodin e Ndërtimit të Sigurte”. Ai vërejti që kjo është bërë në koordinim në mes të departamentit të inxhinierisë dhe Menaxherit Kryesorë të Kompanisë. Arbeni kishte analizuar materialet dhe teknikat e përdorura për dy javë rresht dhe kishte ardhur në përfundim që objekti i tillë nuk do të i rezistonin një tërmeti me shkallë 2.3 Richter. Kriteri i vendosur me Kodin e Ndërtimit të Sigurt është që një objekt banimi duhet të jetë në gjendje që t'i përballoj një tërmeti në 7 shkallë Richter.

Arbeni i ka të gjitha provat që dëshmojnë këto shkelje. Si inxhinier me integritet profesional dhe etike qytetare ka vullnetin dhe ndjenë obligimin që të raportoj këtë ngjarje. Ai vetëm nuk e dinë se si të vazhdoj në sinjalizimin e këtij rasti? A duhet t'i drejtohet drejtorit të kompanisë “Ndërtimi i Dobët” apo ndonjë pale apo institucioni tjetër? Ai dëshiron të dijë si të veproj në këtë rast?

## Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren

Sipas metodologjisë së vendosur më lartë në vijim do të trajtojmë pyetjet e Arbenit në mënyrë rendore. Ai fillimisht dëshiron të dijë si të vazhdoj sinjalizimi i këtij rasti? Më saktë a duhet t'i drejtohet drejtorit të kompanisë "Ndërtimi i Dobët" apo ndonjë pale tjetër?

Në rastin konkret Arbeni ngritë një shqetësim lidhur me cilësinë e ndërtimit, i cili është një shumë serioz dhe urgjent. Objektet ndërtimore duhet të jenë në gjendje që t'i rezistojnë tërmetit deri në 7 shkallë Richter. Në të kundërtën një termet sado i vogël mund të shkaktoj viktima të mëdha në njerëz dhe objekte. Për më tepër, urgjenca e këtij sinjalizimi lidhet me momentin krucial në të cilin shkeljet janë vërejtur. Nëse Arbeni nuk e bënë sinjalizimin tani, kur objekti të ndërtohet mund të jetë vonë dhe pasojat negative do të vërehen vetëm kur fatkeqësia të ndodhë.

Sipas nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve, një nga bazat pse sinjalizimi në interesin publik është i mbrojtur, përfshihen edhe situatat kur "shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet" apo kur "personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor". Si bazë shtesë aty përcaktohet që sinjalizimi është në interes publik kur **"shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet"**. Andaj në rastin konkret të tria këto kritere janë plotësuar.

Në vijim do t'i kthehemi pyetjeve të ngritura më lartë. Sikurse në rastet e tjera, edhe këtu, Arbeni i ka disa alternativa. Ai mund të zgjedh të bëjë sinjalizimin e brendshëm, të jashtëm apo shpalosjen publike.

Sinjalizimi i brendshëm bëhet tek punëdhënësi. Në këtë rast, nëse Arbeni zgjedhë të bëjë sinjalizimin e brendshëm do të mund t'i drejtoheshin kompanisë "Ndërtuesi i Dobët". Sipas Ligjit, sinjalizimi i brendshëm duhet të bëhet tek zyrtari përgjegjës. Mirëpo duhet theksuar që Ligji ka përcaktuar një kriter për subjektet private lidhur me obligimin e pasjes së një zyrtari të tillë. Me nenin 17 par.1 të Ligjit është përcaktuar që vetëm subjektet private me mbi pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës. Andaj, Arbeni duhet të konsiderojë këtë element për të ditur nëse e kanë mundësinë e adresimit të zyrtarit përgjegjës brenda institucionit. Në rast se zyrtari përgjegjës nuk është caktuar për shkak të numrit më të vogël të të punësuarave (më pak se 50) atëherë Arbeni duhet ti drejtohet drejtpërdrejt drejtorit të Kompanisë "Ndërtuesi i Dobët" në pajtim me nenin 17 paragrafi 4 të Ligjit.

Në rast se në gjykimin e Arbenit, sinjalizimi tek zyrtari përgjegjës apo drejtori i kompanisë nuk është apo nuk pritet të jetë efektiv, Arbeni mund të bëjë drejtpërdrejtë sinjalizimin e jashtëm tek organet kompetente. Në rastin konkret organe kompetente mund të përfshijë më shumë se një organ. Duke qenë se fusha e ndërtimit në nivel lokal parimisht mbikëqyret nga Drejtoria e Inspektoratit në nivel lokal/komunal, Arbeni duhet fillimisht t'i drejtohet këtij organi. Alternativisht apo paralelisht, Arbeni mund të zgjedhë që t'i drejtohet edhe Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë përkatësisht Departamenti për Inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor – Divizioni për Inspektim të Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor.

Sipas Ligjit, Arbeni ka edhe një mundësi të fundit nëse alternativat e mësipërme nuk japin apo nuk pritet të japin efekt (kjo gjë duhet të determinohet në secilin rast në gjykimin e sinjalizueseve). Ai mund të bëjë sinjalizimin publik (shpalosjen). Sipas Ligjit, ky sinjalizim mund të bëhet kur:

1. në kohën kur sinjalizuesi që bën shpalosjen, me arsye beson se ai do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bën raportim të brendshëm apo të jashtëm;
2. sinjalizuesi me arsye beson se ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen nëse sinjalizuesi bën raportim në mënyrën e përcaktuar në nenin 16 (sinjalizimi i brendshëm) dhe 18 (sinjalizimi i jashtëm) të këtij ligji.
3. në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo kur shkaktohen dëme në shkallë të gjerë apo të pariparueshme;
4. autoritetet përgjegjëse nga neni 16 dhe 18 të këtij ligji nuk kanë ndërmarrë veprimet përkatëse në lidhje me sinjalizimin brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.

Nëse zgjedhë të bëjë këtë lloj të sinjalizimit, Arbeni duhet respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky sinjalizim mund të bëhet përmes mediave, apo mjeteve tjera të publikimit.



## **SKENARI #5:**

**Sinjalizimi  
në kontekst  
të mbrojtjes  
së shëndetit  
në fushën e  
shëndetësisë**



Njani më tha që me 120 mijë euro kryhet në Gjykatë. E kthejmë rastin në pikën zero tani kqyrim çka po mundemi me ba në OSHP. A po kupton? Duhesh me gjetë një mënyrë me evidentu këtë 120 mijë euro në librat e kontabilitetit.” Genci e njoftoj Drejtorin e Përgjithshëm që do të shoh se çka mund të bëjë.





## SKENARI #5:

# Sinjalizimi në kontekst të mbrojtjes së shëndetit në fushën e shëndetësisë

## Faktet e supozuara



Blerta dhe Nita punojnë si farmacistë në farmacinë “Shërimi i Lirë”. Farmacia është themeluar në vitin 2000 dhe ka 150 punëtor. Ato kohët e fundit kanë vërejtur që Farmacisti Kryesorë ka urdhëruar që bari “Medikamenti 1” të paktohet në paketimin e barit “Medikamenti 2”. Kjo është rreptësishtë e ndaluar me “Ligjin për Farmacinë e Sigurt”. Sipas njohurive të përgjithshme mjekësore këto barëra mundën parimisht të përdoren si zëvendësim për njëri tjetrin. Megjithatë Nita dhe Blerta e dinë se tek pacientët me një gjendje të caktuar shëndetësore “Gjendja Fragile” nëse përdoret Medikamenti 1 në vend të Medikamentit 2 kjo mund të sjellë komplikime në frymëmarrje, të cilat mund të sjellin sulm në tru apo ndonjëherë edhe vdekjen e drejtpërdrejtë. Sipas studimeve të fundit, këto raste ndodhin në 15% të situatave kur këto barëra ngatërrohen për njëra tjetrën. Ky ndikim negativ rrjedhimisht duhet të merret si ekzistent.

Blerta dhe Nita, si farmacistë profesioniste dhe me integritet dhe etikë profesionale nuk mund ta tolerojnë këtë situatë me rrezik të drejtpërdrejtë apo potencial për qytetarët e Kosovës. Ato duan të bëhen sinjalizuese por nuk e dinë se si ta bëjnë këtë? Po ashtu ato duan të dinë nëse duhet që sinjalizimin ta bëjnë përmes mediave apo ka rrugë tjera më diskrete? Nëse po, cilat mënyra dhe mekanizma mund të përdorin Nita dhe Blerta për të adresuar këto shkelje.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Gjatë hulumtimeve të tyre profesionale ato kishin një reference: Biokimisti Jeffrey Wigand shpалosi se ekspozoi se kompania e duhanit Brown & Williamson kishin manipuluar qëllimisht përzierjen e duhanit me kimikate të tilla si amoniaku për të rritur efektin e nikotinës në tymin e cigareve. Gaps in the System: Whistleblower Laws in the EU [www.blueprintforfreespeech.net](http://www.blueprintforfreespeech.net).

## Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren

Sikurse edhe në rastet tjera, Blerta dhe Nita mund të përdorin sinjalizimin e brendshëm, sinjalizimin e jashtëm apo sinjalizimin publik (shpalosjen).

Në vijim duhet të trajtojmë nëse sinjalizimi i tillë është i autorizuar në një nga bazat e përcaktuara në Ligj sipas të cilave sinjalizim konsiderohet në interes publik. Lidhur me këto çështje ne duhet t'i referohemi nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve. Aty përcaktohet se një nga bazat pse sinjalizimi në interesin publik është i mbrojtur, përfshihen edhe situatat kur “shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet” apo kur “personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor”. Si bazë shtesë aty përcaktohet që sinjalizimi është në interes publik kur **“shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet”**. Andaj, në rastin konkret të tria këto kritere janë plotësuar.

Duke qenë se kompania “Shërimi i Lirë” ka mbi 50 punëtor, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve supozohet që kjo kompani ka caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim. Pra hapi i parë që Nita dhe Blerta duhet të ndërmarrin është që ti drejtohen Zyrtarit Përgjegjës për Sinjalizime në kompaninë “Shërimi i Lirë”. Atje, Nita dhe Blerta duhet të paraqesin të gjitha dëshmitë për këto shkelje ligjore që janë duke rrezikuar apo pritet të rrezikojnë shëndetin e njerëzve. Kjo mënyrë e sinjalizimit parashihet dhe autorizohet sipas nenit 16 dhe nenit 17 paragrafi 1-3 i Ligjit. Mirëpo kjo nuk është mënyra e vetme përmes të cilës Nita dhe Blerta mund të bëjnë sinjalizimin e një shkelje të tillë kaq të rrezikshme.

Nëse ato konsiderojnë se sinjalizimi përmes Zyrtarit Përgjegjës nuk pritet të jetë efektiv (kjo gjë duhet të dëshmohet në secilin rast ndaras), atëherë ato mund ta bëjnë sinjalizimin drejtpërdrejtë tek udhëheqësi i kompanisë. Këtë e autorizon neni 17 paragrafi 4 i Ligjit.

Mënyra e dytë e sinjalizimit është ajo sipas nenit 18 pra përmes sinjalizimit të jashtëm. Por ne vërejtëm se Nita dhe Blerta nuk ishin të sigurta se kujt duhet ti drejtohen? Vërejmë që neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve përcakton që në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat sinjalizimi bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë (të listuar me poshtë).

Duke pasur parasysh fushën e shkeljeve të pretenduara mund të kuptojmë që në rast të sinjalizimit të jashtëm Nita dhe Blerta duhet t'i drejtohen:

1. Inspektoratit Farmaceutik që funksionon në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.dhe
2. Ministrisë së Shëndetësisë si organ në kuadër të cilës funksionon Inspektorati Farmaceutik.

Sipas përshkrimit zyrtarë të fushe veprimtarisë, ky Inspektorat është, ndër të tjera, kompetent që të vlerësoj zbatimin e legjislacionit, si dhe marrjen e masave administrative dhe shqiptimin e gjobave që kanë për qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'u shkaktohen shëndetit publik, sigurisë publike dhe mjedisit dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë.

Sipas Ligjit, Nita dhe Blerta kanë edhe një mundësi të fundit nëse alternativat e mësipërme nuk japin apo nuk pritët të japin efekt (kjo gjë duhet të determinohet në secilin rast në gjykimin e sinjalizueseve). Ato mund të bëjë sinjalizimin publik (shpalosjen). Sipas Ligjit, ky sinjalizim mund të bëhet në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Nëse zgjedhin të bëjë këtë lloj të sinjalizimit, Nita dhe Blerta duhet respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky sinjalizim mund të bëhet përmes mediave, Organizatave Jo-Qeveritare, apo mjeteve tjera të publikimit.



## **SKENARI #6:**

**Sinjalizimi për  
mospagesë të  
kontributeve  
pensionale për  
punonjësit e  
marketeve**



Të dytë kuptuan ndërkohë që kolegët e tyre që kontrolluan gjendjen e "Trustit" e kuptuan që kontributet e tyre pensionale nuk po paguheshin. Ata e dinë që kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e një apo disa ligjeve që rregullojnë skemat pensionale.





## SKENARI #6:

# Sinjalizimi për mospagesë të kontributeve pensionale për punonjësit e marketeve

## Faktet e supozuara



Alberti dhe Dreni janë shokë të mire. Ata, dy vitet e fundit kanë punuar në dy supermarket të qytetit të tyre. Një ditë Alberti kishte aplikuar për një vizë dhe rrjedhimisht i duhej të dëshmonte kohëzgjatjen e punësimit përmes gjendjes së “Trustit” (institucioni që menaxhon dhe administron kontributet pensionale). Kur e mori gjendjen për dy vitet e kaluara ai u çudit kur e pa që atij nuk i ishin paguar kontributet pensionale. Pasi e ndau këtë informatë me Drenin, po ashtu edhe Dreni bëri të njëjtën edhe ai e mori vesh që nuk i ishin paguar kontributet pensionale. Më pas ata komunikuan në grupin në “Viber” ku ishin të përfshirë të gjithë punëtorët e sektorëve të ngjashëm tek punëdhënësit e tyre respektiv. Të dytë kuptuan ndërkohë që kolegët e tyre që kontrolluan gjendjen e “Trustit” e kuptuan që kontributet e tyre pensionale nuk po paguheshin. Ata e dinë që kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e një apo disa ligjeve që rregullojnë skemat pensionale. Ata po ashtu besojnë që kjo çështje është në interes publik sepse punëtorët të cilëve nuk ju paguhen kontributet pensionale do të bëhen barrë ekonomike për vendin në çastin e pensionimit. Për më tepër, përmes mjeteve të mbledhura shteti financon skema të ndryshme në interes të përgjithshëm, të cilat më pas i kthen në fondin pensional për ta kompensuar investimin e financuar me mjete të “Trustit”.

Andaj, Alberti dhe Dreni duan të bëjnë sinjalizimin. Ata duan të dinë cilat janë alternativat që ata duhet ti ndjekin.

## Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren

Fillimisht duhet të trajtojmë nëse sinjalizimi i tillë është i autorizuar në një nga bazat e përcaktuara në Ligj sipas të cilave sinjalizim konsiderohet në interes publik. Lidhur me këto çështje ne duhet t'i referohemi nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve. Aty përcaktohet se një nga bazat pse sinjalizimi në interesin publik është i mbrojtur, përfshihen edhe situatat kur "shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet" apo kur "personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor". Andaj në rastin konkret të dyja këto kritere janë plotësuar sepse shkelja e ligjeve të përcaktuara për skemat pensionale është kryer dhe është duke u kryer, e po ashtu edhe personat e caktuar kanë dështuar të veprojnë për të përmbushur detyrimin ligjor të punëdhënësve për të kontribuar në skemat pensionale për të punësuarit.

Sikurse edhe në rastet tjera, Alberti dhe Dreni mund të përdorin sinjalizimin e brendshëm, sinjalizimin e jashtëm apo sinjalizimin publik (shpалosjen).

Duke qenë se maketet në të cilat Alberti dhe Dreni janë të punësuar, supozohet se kanë mbi 50 punëtor, sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve supozohet që kjo kompani ka caktuar zyrtarin përgjegjës për sinjalizim. Pra hapi i parë që Alberti dhe Dreni duhet të ndërmarrin është që ti drejtohen Zyrtarit Përgjegjës për Sinjalizime në marketet ku ata punojnë. Tek Zyrtari Përgjegjës ata duhet të paraqesin të gjitha dëshmitë për këto shkelje ligjore që janë duke ndodhur në raport me mos-pagesën e skemave pensionale të të punësuarve. Kjo mënyrë e sinjalizimit parashihet dhe autorizohet sipas nenit 16 dhe nenit 17 paragrafi 1-3 i Ligjit. Mirëpo kjo nuk është mënyra e vetme përmes të cilës Dreni dhe Alberti mund të bëjnë sinjalizimin e një shkelje të tillë kaq të rrezikshme.

Nëse ato konsiderojnë se sinjalizimi përmes Zyrtarit Përgjegjës nuk pritet të jetë efektiv (kjo gjë duhet të dëshmohet në secilin rast ndaras), atëherë ato mund ta bëjnë sinjalizimin drejtpërdrejtë tek udhëheqësi i kompanisë. Këtë e autorizon neni 17 paragrafi 4 i Ligjit. Nëse as kjo mënyrë nuk pritet të jetë efektive, apo nuk është efektive pasi të jetë shtuar, atëherë Alberti dhe Dreni mund të zgjedhin të bëjnë sinjalizimin e jashtëm.

Vërejmë që neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve përcakton që në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat sinjalizimi bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Duke pasur parasysh fushën e shkeljeve të pretenduara, mund të

përfundojmë që institucione kompetente për sinjalizim të këtij rasti mund të jenë institucionet në vijim:

1. Inspektorati i Punës,
2. Administrata Tatimore e Kosovës, dhe
3. Trusti Pensional i Kosovës.

Këto tre institucione janë kompetente që të mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit të punës, legjislacionit tatimor dhe atij pensional respektivisht. Andaj, sinjalizimi në njërin apo të gjitha nga këto institucione, autorizohet nën 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve dhe legjislacioni përkatës, që rregullon fushë veprimtarinë e këtyre institucioneve të sipër-përmendura.

Sipas Ligjit, Dreni dhe Alberti kanë edhe një mundësi të fundit nëse alternativat e mësipërme nuk japin apo nuk pritet të japin efekt (kjo gjë duhet të determinohet në secilin rast në gjykimin e sinjalizueseve).

Ata mund të bëjnë sinjalizimin publik (shpalosjen) sipas nenit 20 të Ligjit. Nëse zgjedhin të bëjnë këtë lloj të sinjalizimit, Dreni dhe Alberti duhet respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky sinjalizim mund të bëhet përmes mediave, Organizatave Jo-Qeveritare, apo mjeteve tjera të publikimit.




## **SKENARI #7:**

**Sinjalizimi  
për shërbim  
të produkteve  
ushqimore të  
rrezikshme**



Tani, për Dalianin dhe Besën gjithçka kishte kuptim. Edhe helmimi i një grupi të klientëve para 2 javëve. Edhe aroma ndryshe e mishit gjatë gatimit. Ata duan të dinë se a mund të bëhen sinjalizues në këtë rast dhe cilët hapa/procedura duhet të ndjekin?





## SKENARI #7:

# Sinjalizimi për shërbim të produkteve ushqimore të rrezikshme

## Faktet e supozuara



Daliani dhe Besa punojnë në restorantin për ahengje familjare “Dasma e Lumtur”. Kryesisht restoranti bënë organizimin e dasmave dhe ahengjeve tjera festive. Ata punojnë si kuzhinierë. Restoranti i tyre blinte mishin nga maketi “Marketi i Pakujdesshëm”. Një ditë ata panë që mishi kishte një ngjyrë tjetër. Kur u konsultuan me krye-kuzhinierin ai ju kërkoi atyre që “të hedhin mishin e identifikuar dhe të vazhdojnë me punën”. Ata nuk u ndalën me kaq. Me disa kërkime të vogla pas orarit të punës ata kuptuan që mishin që e blinin nga “Marketi i Pakujdesshëm” ishte i skaduar. Të nesërmen ata e ngritën këtë problem me Menaxherin Kryesor. Ai i njoftoi që me dijeninë e drejtorit të përgjithshëm, ai kishte filluar për disa javë që të blinte mishin që është afër skadimit apo i skaduar. “Marketi i Pakujdesshëm” i shiste restorantit atë lloj mishi me çmim 50% më të lirë.

Tani, për Dalianin dhe Besën gjithçka kishte kuptim. Edhe helmimi i një grupi të klientëve para 2 javëve. Edhe aroma ndryshe e mishit gjatë gatimit. Ata duan të dinë se a mund të bëhen sinjalizues në këtë rast dhe cilët hapa/procedura duhet të ndjekin?

## Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren

Në bazë të fakteve të përmendura më lartë vërejmë që Besa dhe Daliani praktikisht e kanë të pamundur të përdorin sinjalizimin e brendshëm (qoftë tek Zyrtari Përgjegjës apo Drejtuesi i Restorantit) për faktin se sipas deklaratave të Menaxherit Kryesor, ishte pikërisht drejtori i përgjithshëm ai që kishte autorizuar blerjen e mishit me afat pranë skadimit apo të sapo skaduar. Prandaj, në rastin konkret, Besës dhe Daliani kanë vetëm dy mënyra të sinjalizimit në dispozicion: a. sinjalizimin e jashtëm dhe b. sinjalizimin publik (shpalosjen).

Në vijim duhet të trajtojmë nëse sinjalizimi i tillë, sipas fakteve të supozuara, është i autorizuar në një nga bazat e përcaktuara në Ligj sipas të cilave sinjalizimi konsiderohet në interes publik. Lidhur me këto çështje ne duhet t'i referohemi nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve. Aty përcaktohet se një nga bazat pse sinjalizimi në interesin publik është i mbrojtur, përfshihen edhe situatat kur "shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet" apo kur "personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor". Si bazë shtesë aty përcaktohet që sinjalizimi është në interes publik kur **"shëndeti apo siguria e individit është rrezikuar, është duke u rrezikuar ose ka gjasa të rrezikohet"**. Andaj në rastin konkret të tria këto kritere janë plotësuar. Sidomos është me rëndësi që të theksohet kriteri i rrezikimit të shëndetit dhe fakti që ky rrezikim është duke ndodhur edhe në momentin që po flasim por ka gjasa të vazhdojë të ekzistojë.

Për sa i përket sinjalizimit të jashtëm, vërejmë që neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve përcakton që në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat sinjalizimi bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Duke pasur parasysh fushën e shkeljeve të pretenduara, mund të përfundojmë që institucione kompetente për sinjalizim të këtij rasti mund të jenë institucionet në vijim:

1. Inspektorati Sanitarë, që funksionon në kuadër të Agjencisë së Veterinarisë dhe Ushqimit në Republikën e Kosovës,
2. Drejtoria e Inspektoratit në nivel Komunal,
3. Inspektorati i Tregut, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Dy institucionet e para janë kompetente që të mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit dhe standardeve sanitare dhe kualitative përkitazi me cilësinë dhe sigurinë e ushqimit. Institucioni i tretë është i autorizuar dhe kompetentë që të bëjë mbikëqyrjen e tregut dhe të kritereve ligjore dhe standardeve tjera në fushën e tregut dhe tregtisë së produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore.

Ata mund të bëjë sinjalizimin publik (shpalosjen) sipas nenit 20 të Ligjit. Nëse zgjedhin të bëjnë këtë lloj të sinjalizimit, Besa dhe Dailani duhet respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky sinjalizim mund të bëhet përmes mediave, Organizatave Jo-Qeveritare, apo mjeteve tjera të publikimit.



## **SKENARI #8:**

**Sinjalizimi në  
kontekst të  
institucioneve  
financiare**



Por të nesërmen ai e pa pronarin e korporatës në fjalë duke nënshkruar kontratën e kredisë tek kolegu i tij (Bankari Lakmitar). Blertoni kërkoj një minutë bisede me Bankarin Lakmitar. Kur e pyeti se pse pronari i Korporatës që Keqpërdorë Taksat po nënshkruante kontratën për të cilën ju kishte refuzuar aplikimi, kolegu i tij ja ktheu "Ky tipi kish fol me Drejtorin.





## SKENARI #8:

# Sinjalizimi në kontekst të institucioneve financiare

## Faktet e supozuara



Blertoni punon bankier në “Bankën e Pasur të Kosovës”. Kjo Bankë kishte marrë një grant nga Qeveria e Kosovës për të mbështetur bizneset e reja, kreditë për bujqësi dhe kreditë për efikasitet të energjisë (që do të thotë që kjo Bankë duhet të stimulojë kreditë që rrisin kursimin e energjisë elektrike, psh. duke i bërë shtëpitë më pak të varura nga ngrohja përmes dritareve me standarde të larta). Këto grante ishin pra të dhëna për Bankën nga paratë e taksapagueseve të Kosovës. Bizneset fillestare mund të aplikojnë për kredi nga 20,000 deri në 400,000 Euro (kriteret ishin gjithnjë e më të larta varësisht nga shuma e kredisë për sa i përket numrit të të punësuarve, aktivitetit ekonomik, tatimeve etj.). Norma e interesit ishte zero dhe afati i kthimit ishte 10 vjet, por nëse punoheshin mbi 100 persona nga ky aktivitet i financuar kredia falej në tërësi. Si organ përgjegjës për mbikëqyrje të granteve ishte caktuar Banka Qendrore e Kosovës.

Një ditë Blertoni i erdhi një aplikacion për kredi nga një “biznes i ri”. Por pas shqyrtimit të dokumentacionit ai e kuptoj që në fakt nuk bëhej fjalë për një biznes të ri por për një kompani mjaftë të njohur (“Korporata që Keqpërdore Taksat”). Korporata aplikonte për 376,000 Euro. Duke qenë banker profesionist por edhe person me integritet profesional dhe etikë pune natyrisht ai e refuzoj këtë kërkesë për kredi duke qenë se nuk i plotësonte kushtet e përcaktuara nga qëllimet për të cilat ishte dedikuar granti. Çështja u duk e mbyllur me kaq.

Por të nesërmen ai e pa pronarin e korporatës në fjalë duke nënshkruar kontratën e kredisë tek kolegu i tij (Bankari Lakmitar). Blertoni kërkoi një minutë bisede me Bankarin Lakmitar. Kur e pyeti se pse pronari i Korporatës që Keqpërdorë Taksat po nënshkruante kontratën për të cilën ju kishte refuzuar aplikimi, kolegu i tij ja ktheu “Ky tipi kish fol me Drejtorin. Bile Drejtori ish nervozua me ty që ja ke refuzuar kërkesën. A e din kush asht ky? Ky është i lidhur me Ministrin e Ministrisë së Bankave

dhe Institucioneve Mikro-Financiare dhe Tregtisë. I kish thanë Drejtorit që nëse nuk ma aprovoni kredinë kam me jua tërheq edhe licencën. Edhe Ministri e kish thirr Drejtorin, është komplikua shume situata”.

Atë ditë Blertoni u ftua në takim me Drejtorin. Ai nuk ndryshoj qëndrimin sepse e dinte dhe ja tha edhe Drejtorit që Korporata që Keqpërdorë Taksat nuk kualifikohej për këtë kredi. Ai shpëtoj nga ky takim me një “vërejtje” verbale. Drejtori po ashtu i kërkoi Blertonit që “të mos ta bënte këtë punë të madhe” dhe që “nëse ke ndonjë shok që ka biznes le të vjen të aplikoj se ja aprovovmë kredinë si favor ndaj tij”. Duke qenë person me integritet Blertoni nuk mund ta toleronte këtë situatë. Ai vendosi që të sinjalizojë. Ai dëshiron të di se si ta bëjë këtë dhe kujt t’i drejtohet.

## **Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren**

Ne faktet e sipër theksuara kemi dy situata. E para ka të bëjë me sinjalizimin në raport me Drejtorin dhe Bankën. E dyta ka të bëjë me sinjalizimin në raport me Korporatën që Keqpërdorë Taksat dhe Ministrin. Andaj edhe pjesën vijuese do ta ndajmë në dy pjesë.

### **1. Sinjalizimi në raport me Bankën**

Duke qenë se, sipas fakteve të supozuara, drejtori i Bankës e dinte për shkeljen, sinjalizimi i brendshëm tek zyrtari përgjueses apo Drejtori është e pritshme që të jetë një sinjalizim joefektiv me që ai vet ka urdhëruar veprimin për të cilin po bëhet sinjalizimi.

Prandaj, në rastin konkret, Blertonit kanë vetëm dy mënyra të sinjalizimit në dispozicion: a. sinjalizimin e jashtëm dhe b. sinjalizimin publik (shpalosjen).

Në vijim duhet të trajtojmë nëse sinjalizimi i tillë i jashtëm, sipas fakteve të supozuara, është i autorizuar në një nga bazat e përcaktuara në Ligj sipas të cilave sinjalizim konsiderohet në interes publik. Lidhur me këto çështje ne duhet të i referohemi nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve. Aty përcaktohet se një nga bazat pse sinjalizimi në interesin publik është i mbrojtur, përfshihen edhe situatat kur “shkelja është kryer, është duke u kryer apo ka gjasa të kryhet” apo kur “personi ka dështuar, është duke dështuar ose ka gjasa të dështoj të përmbush ndonjë detyrim ligjor”. Si bazë tjetër për sinjalizimin në interes publik përcaktohet

edhe situata kur “**ka pasur keqpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit të parave publike ose resurseve të një institucioni publik, kjo është duke ndodhur ose ka gjasa të ndodhë**”. Andaj në rastin konkret të dyja këto kriterë janë plotësuar. Sidomos është me rëndësi që të theksohet kriteri i rrezikimi të shëndetit dhe fakti që ky rrezikim është duke ndodhur edhe në momentin që po flasim por ka gjasa të vazhdojë të ekzistojë në raport me sinjalizimin në raport me shërbimin e materies së pa lejueshme në kafe.

Vërejmë që neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve përcakton që në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat sinjalizimi bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë (që do të përmenden në vijim). Duke pasur parasysh fushën e shkeljeve të pretenduara, mund të përfundojmë që institucione kompetente për sinjalizim të këtij rasti në raport me Drejtorin dhe Bankën e Pasur të Kosovës, janë:

1. Qeveria e Kosovës si donatore e Grantit për kreditë në fjalë;
2. Banka Qendrore e Kosovës si organ rregullator i sistemit bankar në Kosovë,
3. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), përkatësisht Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative (ZGJONA) apo departamenti tjetër përkatës sipas instruksioneve të dhëna nga ATK.

Këto institucione/organe janë kompetente që të mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit të bankar dhe tatimor. Andaj, sinjalizimi në njërën apo të gjitha nga këto institucione autorizohet neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve dhe legjislacioni përkatës që rregullon fushë veprimtarinë e këtyre institucioneve të sipër-përmendura.

## **2. Sinjalizimi në raport me Pronarin e Korporatës që Keqpërdor Taksat dhe Ministrin**

Në raport me sinjalizimin e këtyre shkeljeve, nga faktet e supozuara, vërejmë që pronari i korporatës dhe Ministri e kishin thirrur Drejtorin e Bankës duke i bërë presion dhe shantazhuar që nëse kredia nuk aprovohej banka do të pësonte pasoja negative.

Edhe pse njëri nga këta persona është person zyrtar publik, duke qenë se shkelja që ka nxitur sinjalizimin ka lindur në kontekst të një raporti privat (aplikimi për kredi), prapë se prapë Blertoni mund të mbështetet në pjesët e tjera të ligjit për

sinjalizimin në kontekst publik. Aty vërejmë që sipas nenit 19 paragrafi 3 organ kompetent për të ju drejtuar për këtë sinjalizim në raport me Ministrin dhe Drejtorin është:

1. Agjencia kundër Korrupsionit.

Mirëpo duke qenë se veprat e tilla me shumë gjasë konsumojnë një apo disa vepra penale sinjalizimi në këtë rast paralelisht me sinjalizimin tek Agjencia, mund të bëhet edhe në organet vijuese:

2. Policinë e Kosovës, Departamenti për Krime Ekonomike,
3. Prokurorinë e Shtetit,

Këto institucionet të përmendura janë kompetente që të mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit nga fusha e korrupsionit dhe veprave penale e kriminalitetit në përgjithësi.

Por Blertoni mund të bëjë sinjalizimin publik (shpalosjen) sipas nenit 20 të Ligjit. Nëse zgjedhin të bëjnë të bëjë këtë lloj të sinjalizimit, Blertoni duhet respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky sinjalizim mund të bëhet përmes mediave, Organizatave Jo-Qeveritare, apo mjeteve tjera të publikimit.

## **SKENARI #9:**

**Sinjalizimi  
për cënim të  
të dhënave  
personale**



Programi mblidhte të dhëna mbi kërkimet e përdoruesit të kompjuterit, kishte qasje në emailet që dërgoheshin dhe pranoheshin, thirrjet që bëheshin në programet e instaluara në kompjuter e madje edhe në transaksionet online përmes bankave (ndonëse program nuk mund të urdhëronte vet ndonjë transaksion por vetëm mund të vëzhgonte transaksionet).





## SKENARI #9:

# Sinjalizimi për cënim të të dhënave personale

## Faktet e supozuara



Besiani punon si ekspert i teknologjisë në dyqanin e kompjuterëve dhe tabletëve “Kompjuteri i Shpejtë”. Ai ka diplomuar për teknologji dhe është njohës i mire i programimit (software) dhe pjesëve të kompjuterit (hardware). Një ditë menaxheri i tij i drejtpërdrejtë i kërkoi atij që në të gjithë kompjuterët dhe tabletët e ardhshëm që shesin të instalonte një program të vogël të quajtur “Tinëzari”.

Besiani, duke qenë ekspert i teknologjisë dhe programimit një natë e mori këtë program me një disk të jashtëm dhe e analizoi në detaje në shtëpi. Ai u shqetësua tepër kur e kuptoi që programi kishte aftësinë të qëndronte i fshehur në kompjuterin që instalohet dhe të dërgonte të dhëna të ndjeshme tek një adresë. Adresa ishte si në vijim: [partia.politike.kosove@gmail.com](mailto:partia.politike.kosove@gmail.com). Të nesërmen Besiani e konfrontoi Menaxherin e tij. Pasi ishte zbuluar, Menaxheri e pranoi që këtë e bënte sepse kompanisë së tyre i ishin ofruar 600.000 Euro nëse e instalonin këtë program në secilin kompjuter. Kur Besiani e pyeti Menaxherin se nga kush i ishin ofruar këto, ai nuk tregoi, por ai e pranoi se drejtori i përgjithshëm e dinte për këtë ngjarje dhe se ai i kishte ofruar Menaxherit një pagë prej 4000 Euro në muaj për 5 vitet e ardhshme.

Duke mos besuar se çka kishte dëgjuar e kuptuar, Besiani vendosi të analizonte Programin “Tinëzari” më tutje. Ai kuptoi që të dhënat dërgoheshin në adresë të një partie politike në Kosovë. Programi mbledhte të dhëna mbi kërkimet e përdoruesit të kompjuterit, kishte qasje në emailin që dërgoheshin dhe pranoheshin, thirrjet që bëheshin në programet e instaluar në kompjuter e madje edhe në transaksionet online përmes bankave (ndonëse programi nuk mund të urdhëronte vetë ndonjë transaksion por vetëm mund të vëzhgonte transaksionet). Duhet shtuar që kompania “Kompjuteri i Shpejtë” zotëron 45% të tregut dhe ka aktivitete dhe objekte shitëse në tërë territorin e Shtetit.

I shokuar me këto që pa dhe kuptoj Besiani është i interesuar të bëjë sinjalizimin e këtij rasti. Ai dëshiron të di si ta bëjë këtë dhe kujt duhet ti drejtohet?

## **Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren**

Vërejmë që rasti konkret ngritë shqetësime mjaftë serioze për dy arsye të fuqishme dhe shqetësuese. Së pari, ka një cenim të kundërligjshëm në të dhënat personale dhe në sistemet kompjuterike të individëve (blerësve) dhe së dyti këto bëhen nga një parti politike me qëllim të krijimit të një avantazhi duke pasur në dorë të dhëna të shumta personale të qytetarëve të Shtetit.

Duke qenë se drejtori i përgjithshëm i institucionit ishte në bashkë-kryerje të veprimit për të cilin bëhet sinjalizimit, mund të themi që sinjalizimi i brendshëm nuk pritet të jetë efektiv. Andaj Besiani ka vetëm dy mundësi për sinjalizim: a. sinjalizimin e jashtëm dhe b. sinjalizimin publik (shpalosjen).

Vërejmë që neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve përcakton që në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat sinjalizimi bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë.

Duke pasur parasysh fushën e shkeljeve të pretenduara, mund të përfundojmë që institucione kompetente për sinjalizim të këtij rasti mund të jenë institucionet në vijim:

4. Agjencia për Informim dhe Privatësi,
5. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Këto dy institucione janë kompetente që të mbikëqyrin zbatimin e legjisllacionit mbi të dhënat personale dhe atë mbi funksionimin dhe masat ndaj partive politike respektivisht. Andaj sinjalizimi në njërin apo të gjitha nga këto institucione autorizohet neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve dhe legjisllacioni përkatës që rregullon fushë veprimtarinë e këtyre institucioneve të sipër-përmendura.

Besiani ka edhe një mundësi të fundit nëse alternativa e mësipërme nuk jep apo nuk pritet të jep efekt (kjo gjë duhet të determinohet në secilin rast në gjykimin e sinjalizueseve). Ai mund të bëjë sinjalizimin publik (shpalosjen). Sipas Ligjit, ky sinjalizim mund të bëhet kur:

1. në kohën kur sinjalizuesi që bën shpалosjen, me arsye beson se ai do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bën raportim të brendshëm apo të jashtëm;
2. sinjalizuesi me arsye beson se ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen nëse sinjalizuesi bën raportim në mënyrën e përcaktuar në nenin 16 (sinjalizimi i brendshëm) dhe 18 (sinjalizimi i jashtëm) të këtij ligji.
3. në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo kur shkaktohen dëme në shkallë të gjerë apo të pariparueshme;
4. autoritetet përgjegjëse nga neni 16 dhe 18 të këtij ligji nuk kanë ndërmarrë veprimet përkatëse në lidhje me sinjalizimin brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.

Duke pasur parasysh natyrën dhe mënyrën sistematike të shkeljes së legjislacionit mbi të dhënat personale por edhe të ligjeve tjera, dhe duke pasur parasysh interesin e lartë të publikut që të dijë për këto shkelje, në raste të ngjashme preferohet edhe shpалosja publike. Nëse Besiani zgjedhë të bëjë këtë lloj të sinjalizimit, duhet respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky sinjalizim mund të bëhet përmes mediave, apo mjeteve tjera të publikimit.



## **SKENARI #10:**

**Sinjalizimi për  
shkelje të të  
drejtave të  
autorit**



Duke qenë se inspektoratet përkatëse kishin pamundësuar fotokopjimin e paautorizuar të librave gjatë ditës, pronari i fotokopjes i kishte thënë Menaxherit që të organizonte një ndërrim të vogël të punëtorëve natën që të fotokopjonin librat kur inspektimet nuk pritej të ndodhnin.





## SKENARI #10:

# Sinjalizimi për shkelje të të drejtave të autorit

## Faktet e supozuara



Blerta punon në fotokopjen/shtypshkronjën “Printimi Kualitativ”. Gjatë ditës ajo me kolegët dhe koleget e saj ju ndihmojnë studentëve në printimin e materialeve për studime. Mirëpo ka 1 muaj që Menaxheri i Fotokopjes i ka ftuar punëtorët (10 punëtorë gjithsej punojnë në këtë shtypshkronjë) që të dalin në punë me ndërrime natën. Kur i erdhi radha Blertës të punojë natën ajo e kuptoj arsyeën pse ishte ndryshuar ndërrimi i punës.

Duke qenë se inspektoratet përkatëse kishin pamundësuar fotokopjimin e paautorizuar të librave gjatë ditës, pronari i fotokopjes i kishte thënë Menaxherit që të organizonte një ndërrim të vogël të punëtorëve natën që të fotokopjonin librat kur inspektimet nuk pritej të ndodhnin.

Blerta ka një lidhje të veçantë me librat sepse babai i saj ishte shkrimtarë. Ajo ishte rritur në varfëri edhe pse babai i saj mund të shiste librat. Por ajo nuk ndodhte sepse njerëzit nuk i blinin librat e tij por blinin kopje që shiteshin 70% më lirë. Andaj ajo vendosi që, duke ndjerë edhe një obligim personal, ta sinjalizojë rastin. Ajo dëshiron të dijë si? dhe kujt ti drejtohet?

## Veprimet që mund apo duhet të ndërmerren

Duke qenë se në rastin konkret menaxheri dhe drejtori i fotokopjes e dinin dhe ishin bashkautor të ngjarjes në sinjalizim e sipër, dhe duke pasur parasysh që fotokopja me gjasë nuk ka të caktuar zyrtarë përgjegjës për sinjalizim (me që ka më pak se 50 punëtor), atëherë kuptojmë që Blerta në fakt ka vetëm dy mundësi për sinjalizim. Më saktë ajo mund të zgjedh të bëjë sinjalizimin e jashtëm apo sinjalizimin publik (shpalosjen).

Për sa i përket sinjalizimit të jashtëm, vërejmë që neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve përcakton që në lidhje me sinjalizimin në sektorin privat sinjalizimi bëhet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë. Duke pasur parasysh fushën e shkeljeve të pretenduara, mund të përfundojmë që institucion kompetent për të sinjalizuar këtë shkelje është Zyra për Të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta që funksionon në kuadër të Ministrisë së Kulturës.

Ky institucion është përgjegjës dhe kompetent për zbatimin e të legjislacionit që lidhet me të drejtat e autorit. Andaj, sinjalizimi në këtë Zyrë autorizohet neni 19 i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizueseve dhe legjislacioni përkatës që rregullon fushë veprimtarinë e këtyre institucioneve të sipër-përmendura.

Blerta ka edhe një mundësi të fundit nëse alternativa e mësipërme nuk jep apo nuk pritet të japin efekt (kjo gjë duhet të determinohet në secilin rast në gjykimin e sinjalizueseve). Ajo mund të bëjë sinjalizimin publik (shpalosjen). Sipas Ligjit, ky sinjalizim mund të bëhet kur:

5. në kohën kur sinjalizuesi që bën shpalosjen, me arsye beson se ai do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bën raportim të brendshëm apo të jashtëm;
6. sinjalizuesi me arsye beson se ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen nëse sinjalizuesi bën raportim në mënyrën e përcaktuar në nenin 16 (sinjalizimi i brendshëm) dhe 18 (sinjalizimi i jashtëm) të këtij ligji.
7. në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë, mjedisin, apo kur shkaktohen dëme në shkallë të gjerë apo të pariparueshme;
8. autoritetet përgjegjëse nga neni 16 dhe 18 të këtij ligji nuk kanë ndërmarrë veprimet përkatëse në lidhje me sinjalizimin brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga momenti i raportimit të informacionit të sinjalizuar.

Duke pasur parasysh natyrën dhe mënyrën sistematike të shkeljes së legjislacionit mbi të dhënat personale por edhe të ligjeve tjera, dhe duke pasur parasysh interesin e lartë të publikut që të dijë për këto shkelje, në raste të ngjashme preferohet edhe shpalosja publike. Nëse Blerta zgjedhë të bëjë këtë lloj të sinjalizimit, duhet respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore. Ky sinjalizim mund të bëhet përmes mediave, apo mjeteve tjera të publikimit.



